



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 08.06.2022, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Flutura Aça – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

- Miratimi i procesverbalit të datës 24 qershor 2022
- Diskutimi dhe miratimi i projektrezolutës për Raportin e veprimtarisë njëvjeçare të Radiotelevizionit Shqiptar për vitin 2021 (*komision përgjegjës*).

**Marrin pjesë:**

Flutura Aça, Petro Koçi, Besion Ajazi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Ilir Topi, Lindita Buxheli, Meri Markiçi, Luçiano Boçi, Ina Zhupa, Eralda Bano, Andia Ulliri, Merita Baku dhe Kastriot Piroli.

**Mungojnë:**

Blerina Gjylameti, Enslemvera Zake, Agron Gjekmarkaj.

## HAPET MBLEDHJA

**Flutura Aça** – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Kuorumi është i plotë, kështu që ne mund të fillojmë mbledhjen e datës 8 qershor, të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Siç e kemi vendosur bashkërisht, mbledhja e parë ka lidhje me diskutimin dhe miratimin e projektrezolutës “Mbi Raportin e veprimtarisë së Radiotelevizionit Shqiptar për vitin 2021”.

Koleget relatores, që kanë qenë zonja Buxheli dhe zonja Zhupa, kanë përgatitur materialin dhe ndoshta kanë ndonjë shtesë për të bërë, por, gjithsesi, ne do ta... E mira është që dikush ta lexojë, ndoshta zonja Buxheli, për të vijuar më pas me diskutimet.

**Lindita Buxheli** – Projektrezolutë: “Kuvendi i Shqipërisë, duke vlerësuar rolin e RTSH-së në drejtim të përmbushjes së misionit të saj, realizimit të shërbimeve cilësore të radios dhe televizionit për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun, duke i shërbyer kombit, të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë dhe pakicat kombëtare;

-duke njohur përpjekjet e RTSH-së për realizimin e programeve cilësore, ofrimin e një game të gjerë projektesh në interes të grupeve të ndryshme sociale, rritjen e audiencës dhe shtrirjen sa më të madhe në vend;

-duke konsideruar se veprimtaria e RTSH-së është kryer në përputhje të plotë me detyrimin për të pasur nga ana e saj një mbulim të paanshëm dhe të balancuar të lajmeve të vendit dhe atyre ndërkombëtare, duke bërë të mundur rritjen e besimit të publikut;

Vlerëson veprimtarinë e Radiotelevizionit Shqiptar gjatë vitit 2021 në drejtim të:

- prodhimtarisë së lartë televizive, si: emisione, dokumentarë, reportazhe, prodhime origjinale dhe shumë bashkëpunime si partner medietik i një sërë ngjarjesh artistike;

- rikonceptimit të imazhit të RTSH-së, rinovimit të studiove dhe ndryshimit të skenografive që ofrojnë një imazh dhe cilësi më të mirë, për të qenë sa më konkurrues në tregun medietik;

- pasurimit të kanalit “RTSH Shkollë”, krahas kurrikulës mësimore edhe me emisione argëtuese dhe edukative, me qëllim zgjimin e kuriozitetit dhe mbajtjen e audiencës të angazhuar;

- shtimit të kategorive të reja në postimet promovionale *online* në mediat sociale, për të kuptuar se sa të përfshirë apo të përfaqësuar ndihen pjesë të ndryshme të shoqërisë;

- përmirësimin të strukturës së kanalit “RTSH 1”, si kanali i parë në rrafshin editorial, duke gjeneruar ide të reja e duke bërë një monitorim të saktë e me rezultate të kënaqshme për produktin televiziv;

- ridimensionimin të programit të Radios, sipas modelit që imponon aktualiteti, në mënyrë që ajo të ofrojë dobishmëri dhe strategji për përballimin e sfidave.

Kuvendi rekomandon që RTSH-ja për vitin 2022 ta përmirësojë punën në drejtimet si vijojnë:

Së pari, Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar t'i mundësohen burime financiare dhe njerëzore në funksion të ushtrimit të të gjitha kompetencave që i ngarkon ligji nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, duke mundësuar publikimin e veprimtarisë së Këshillit dhe të akteve të miratuara prej tij.

Së dyti, të angazhohet në vazhdimësi për zbatimin e rekomandimeve të adresuara nga institucionet kushtetuese mbikëqyrëse, duke marrë masat e nevojshme për parandalimin e efekteve negative në përdorimin e fondeve publike, si dhe të hartojë e publikojë një raport në lidhje me detyrimet e subjekteve debitoare të krijuara nga kontratat e qirave dhe kontratat e marketingut, me qëllim vjeljen e debitorëve dhe evidentimin e përgjegjësive për krijimin e tyre, përfshirë edhe aplikimin e kamatave. Të publikojë në faqe, përveç shpenzimeve të festivaleve, edhe shpenzimet për aktivitete të tjera të rëndësishme, si dhe të ardhurat e përfituara prej këtyre aktiviteteve.

Së treti, në kuadër të transparencës dhe menaxhimit të shëndoshë, të publikohet veprimtaria e Bordit të Administrimit dhe aktet e miratuara prej tij.

Së katërti, procedurat e rekrutimit të kryhen mbi plane pranimi vjetore, mbështetur në analiza mbi nevojat e institucionit, duke respektuar në çdo rast me përpikëri procedurat ligjore, si dhe të investohet në kualifikimin dhe trajnimin e punonjësve aktualë, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të punës dhe shmangien e qarkullimit të shpeshtë të tyre.

Së pesti, të planifikojë një buxhet të posaçëm dhe të përgatisë një plan tekniko-financiar për shpëtimin dhe digjitalizimin e të gjitha materialeve të ndodhura në Arkivin e filmit.

Së gjashti, të zhvillojë Drejtorinë e Promocionit dhe Sektorin e Kërkimit të Tregut, duke vlerësuar nevojat e publikut apo grupeve të ndryshme të interesit për realizimin e programeve që mund të jenë me shumë interes për to, në mënyrë që të rritet shikueshmëria, kërkesat për promovim dhe si rrjedhim të ardhurat për institucionin.

Së shtati, të angazhohet menjëherë për rikonfigurimin e faqes zyrtare *online* të RTSH-së dhe në funksion të transparencës të publikojë dokumentet sipas përcaktimit të nenit 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe organikën, strukturën organizative, duke përditësuar në lidhje me çdo ndryshim apo vakancë të krijuar.

Së teti, në kanalin “RTSH Kuvend”, si një hapësirë ku ndjekësit kanë akses të shikojnë të plota transmetimet e seancave parlamentare ose punimet e komisioneve të përhershme parlamentare, të përfshihen edhe përmbajtje informuese dhe shpjeguese, të realizuara përmes bisedave, intervistave apo analizave profesionale me ekspertë të fushës, mbi projektligje që janë në proces diskutimi dhe që janë me rëndësi për qytetarin dhe komunitetin, në funksion të konsultimit publik për aktet ligjore, para se ato të diskutohen dhe të votohen në seancë plenare nga deputetët.

Së nënti dhe së fundi, në kanalin “RTSH 2” të bëhet një përfaqësim më gjithëpërfshirës i minoriteteve, të ofrohet bashkëpunimi me persona nga të shtata minoritetet për të cilat transmetohet, si dhe të sigurohet, në mënyrë të pandërprerë, transmetimi me gjuhën e shenjave, në dy kanale gjeneraliste të buketës programore me të paktën një edicion informativ brenda 24 orëve”.

Kjo ishte projektrezoluta.

**Flutura Aça** – Faleminderit, zonja Buxheli!

Kush e do fjalën për diskutim? Ka dikush diçka për të shtuar?

Po, zoti Koçi.

**Petro Koçi** – Tani, unë mendoj se projektrezoluta është gjithëpërfshirëse në kuptimin e shqetësimeve dhe të debateve që ne kemi bërë gjatë dëgjësës qoftë me përfaqësuesit e Këshillit, qoftë të Radiotelevizionit.

Janë bërë nja dy propozime, që unë mendoj se mund të rregullohen me redaktim. Domethënë, të mos e shtojmë pikën 10, por te pika 9, çështja e transmetimit në gjuhën e shenjave, të rregullohet duke përfshirë edhe rekrutimin, pra sepse te propozimi që ka bërë zonja Zhupa thuhet: të bëhet rekrutimi, po themi, i ekspertëve që dinë të komunikojnë me gjuhën e shenjave.

Pra, aty mund të bëhet me redaktim, duke përfshirë edhe rekrutimin.

Unë besoj se të gjithë e gjejnë veten në këtë projektrezolutë. Madje, të mos harrojmë se kjo projektrezolutë lidhet me veprimtarinë e Televizionit për 21-shin, nuk është se është një projektrezolutë që do të kthehet në rezolutë nga Kuvendi që, po themi, se e kthen vështrimin edhe nga ne vetë. Praktikisht, unë mendoj se ka nevojë, për shembull, për të riparë edhe legjislationin, në mënyrën se si funksionon Këshilli, si zgjidhet kryetari e të tjera.

Pra, ka gjëra që duhen parë edhe në këshillimin që mund të bëhet me ekspertët e EBU-së, të Unionit të Transmetuesve Publikë europianë, të cilët gjithashtu kanë disa sugjerime, por që nuk lidhen direkt me Televizionin.

Sigurisht, në ato çështjet e transparencës, pra plotësimi i faqes së *Web-it* në kohë, pra po themi *live*, është e domosdoshme dhe është urdhëruese, sepse rezoluta e detyron qoftë Bordin, qoftë Televizionin të veprojë menjëherë.

E dyta, të komunikohen në kohë reale të gjitha vendimet dhe mënyra se si funksionon vetë Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit. Të gjitha këto janë shumë të rëndësishme dhe janë në projektrezolutë.

Kështu që unë jam dakord të kalojë.

**Flutura Açka** – Faleminderit, zoti Koçi!

Zoti Ajazi.

**Besion Ajazi** – Faleminderit, kryetare!

Në mbështetje edhe të asaj që tha zoti Koçi, patjetër, kjo projektrezolutë i përmban të gjitha sa ne diskutuam edhe para disa ditësh, kur kishim të ftuar drejtuesit kryesorë të Radiotelevizionit Shqiptar.

Sigurisht, edhe në projektrezolutë, por edhe ne vetë i përshëndetëm disa arritje të qenësishme të Radiotelevizionit Shqiptar, siç janë: “RTSH Shkolla”, përmirësimi i programacionit, rikonstruksioni i studiove, balancimi i politikave redaksionale e shumëçka nga këto. Sigurisht, edhe shumë nga ato që ne diskutuam këtu, që janë shqetësime reale, janë të përfshira në projektrezolutë.

Më duhet të them se kjo është projektrezoluta e dytë që në shumë pak kohë e kalojmë me konsensus këtu në komision, gjë e cila tregon se ngrihemi mbi ndasitë tona politike këtu të të dyja krahëve, kur vjen puna te çështje që shqetësojnë komunitetin, që shqetësojnë të gjithë shqiptarët.

Kështu, jemi në mbështetje të kësaj projektrezolute. Besoj se do ta bëjë RTSH-në edhe më të përgjegjshme, edhe më të gatshme për t’iu përgjigjur sfidave të kohës.

Faleminderit!

**Flutura Açka** – Faleminderit, zoti Ajazi!

Ndonjë koleg tjetër?

Nëse nuk ka ndonjë gjë, kisha nevojë për nja dy shtesa të vogla ose gjëra që më shqetësojnë mua lidhur me Radiotelevizionin Shqiptar.

T’ju them të drejtën, ka qenë shtëpia ime e parë publike. Kështu që kam një dobësi të jashtëzakonshme. Unë kam qenë vajzë e re, kur një zotëri shumë i nderuar, regjisori Ylli Pepo,

në atë kohë shumë aktiv, thërriste: “Hajde, fol!”, por unë nuk dija çfarë të flisja, isha vajzë shumë e re!

Ja që Televizioni është vërtet një nga gjërat shumë të dashura të miat, ndaj e kam shqetësim dhe e ndjek vazhdimisht aktivitetin e tij.

Sigurisht, ndodhia me ish-drejtorin i ka lënë një hije të rëndë, të cilën ne duhet ta pranojmë bashkërisht dhe ta ndihmojmë Televizionin shqiptar të çlirohet nga kjo hije, ndaj mendoj se një lloj rezolute e kësaj natyre e ndihmon atë edhe në këtë çështje, edhe në këtë pikë.

Të gjithë e dimë se një pjesë të kohës Televizioni shqiptar bëhet strehë edhe për analistë, të themi, njerëz të medias, të cilët shkëputen nga një televizion privat dhe e kanë shumë të sigurt vendin në Televizionin shqiptar. Por Televizioni shqiptar nuk është fole për njerëz, apo jo, që t’u krijojë komoditete, të rehatojë njerëz të cilët mbeten në një moment të caktuar pa punë! Nuk është ky Televizioni shqiptar.

Nuk e vë në dyshim fare aftësinë dhe cilësinë e asnjërit në këtë botë, por këto gjëra nuk mund të bëhen kështu, sepse nuk është balancë e drejtë!

Ka përmirësime, se nuk mund të them dot se nuk ka, por çështja tjetër lidhet me kthimin e Televizionit shqiptar në një lloj, po them, megafoni të qeverisë. Kjo gjë ka qenë gjithmonë një gangrenë edhe në kohën kur kanë drejtuar të djathtët, edhe në kohën kur kanë drejtuar të majtët; ka qenë një problem shumë i madh.

Të duket se Televizioni shqiptar nuk ka lidhje më fare me publikun, por vetëm me kthimin në një lloj megafoni të qeverisë, gjë të cilën ne sërish mund ta vendosim në rezolutë, si një pikë që ne do të donim të përsosej më shumë, derisa të arrijë atë që është perfekte dhe që e kanë të gjitha televizionet publike të Europës. Ndoshta mund ta shtonim një rresht diku që ne do të dëshironim të kishte edhe një lloj përmirësimi të dukshëm më tutje.

Lidhur me çështjen e ngritur nga dy deputetët e opozitës, zonja Zhupa dhe zoti Boçi, gjatë dëgjësës me përfaqësuesit e Këshillit Drejtues të RTSH-së, njëra ishte çështja e mungesës së balancës në Këshillin Drejtues dhe çështja tjetër ishte zgjedhja e drejtorit të Televizionit Shqiptar në mungesë të një kuorumi të nevojshëm sipas ligjit, nuk e di se çfarë mund të bëjmë me këto, nëse keni ju ndonjë gjë për të shtuar në këtë pikë. Por meqenëse kjo është ngritur nga deputetët e opozitës, ne mendojmë se nuk mund ta anashkalojmë si çështje, pavarësisht se të dy deputetët në fjalë nuk janë për momentin prezentë që të mund ta artikulonin vetë, por ne jemi të detyruar që ta trajtojmë si çështje.

Keni ndonjë ide se si mund të vijë kjo në relacion?

**Petro Koçi** – E para, lidhur me çështjen e balancës politike në edicionet informative, unë mendoj se është një arritje e Televizionit shqiptar... Madje unë mund të them se privatët janë shumë më keq për punën e disbalancave.

Mendoj se Televizioni më i balancuar nga pikëpamja politike në edicionet informative është pikërisht Radiotelevizioni Shqiptar. Domethënë, këtë nuk e them sepse dua të mbroj një institucion për të cilin unë jam realisht shumë kritik, me thënë të drejtën, për aspekte të tjera, por për këtë aspekt mendoj se meriton një notë shumë pozitive, të paktën për periudhën që ne po flasim, për vitin 2021.

Tani, lidhur me pretendimet e tjera, unë mendoj se këto nuk i drejtohen dot Radiotelevizionit, por janë çështje që lidhen me veprimtarinë e Kuvendit. Pra, në momentin kur Kuvendi ka qenë me atë përbërje që ka qenë, se nuk duhet t'i hyjmë tani analizës se kush i bën listat e deputetëve, kush doli e kush hyri, por kjo është një çështje... Është politike dhe është, domethënë, një çështje të cilën ne e kemi trajtuar herë pas here edhe në komunikim, po themi, me aktorë ndërkombëtarë.

Ajo është një gjë që ka ndodhur në atë kohë dhe që nga pikëpamja formale është një gjë që nuk zhbëhet dot, sigurisht, duke e njohur në aspektin moral, por nga pikëpamja ligjore nuk është se kemi ne hapësirë për të vepruar. Por, gjithsesi, kjo është një çështje që prapë na përket neve, si Kuvend flas, sepse ai ka qenë vendim i Kuvendit, me përbërjen që ka pasur në atë kohë.

Kështu, mendoj të mos e prishim konsensualitetin për çfarë kemi bërë deri tani, sepse diskutimet unë mendoj se kanë qenë shumë të përgjegjshme radhën e parë, kur është bërë dëgjesa, por mendoj se edhe projektrezoluta e plotësuar edhe me ato çështjet që lidhen me transparencën dhe me transmetimet në gjuhën e shenjave për një komunitet që, sigurisht, shqisat e perceptimit nuk i ka në nivelin e zakonshëm... Kështu që unë mendoj të mos e ngatërrojmë më tej, të mos e bëjmë kështu me punë votash.

Tani, në Kuvend, kur të bëhet seanca, mendoj se aty e kemi lirinë e plotë...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

...për t'iu drejtuar edhe çështjeve që nuk lidhen me Radiotelevizionin në vetvete, në kuptimin me veprimtarinë politike të Kuvendit. Aty, po, unë mendoj se opozita mund ta ngrerë çështje që, shiko, kur është bërë ai vendimi për të ngritur bordin...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Po pra, sigurisht!

E kam fjalën...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Por nuk varet nga ata!

Shikoni, kjo është një rezolutë për veprimtarinë e tyre, jo tonën!

Në seancë dhe në diskutimet që ne bëjmë, sigurisht, ne u drejtohem edhe vetë dhe themi: këtu mund të bëjmë edhe debat politik që, jo ju, jo ne e të tjera, por projektrezoluta, se në fund do të kthehet në rezolutë, është për veprimtarinë e Radiotelevizionit Shqiptar në vitin 2021, që ka dy institucione, Bordin ose Këshillin dhe vetë Televizionin si ekzekutiv.

Mendoj se në debat pastaj, sigurisht, ne e shohim edhe në këndvështrimin politik, është normale. Domethënë, një pjesë e sheh ndryshe atë periudhën e atij Kuvendi, kur iku opozita e të tjera, por që kjo nuk u përket atyre. Kjo është ideja. Pra, nuk është faji i tyre, pavarësisht se një pjesë janë produkt i atij Kuvendi, por ata nuk janë bashkëfajtorë fare... Kjo është çështje e politikës dhe prandaj po them që në diskutime, hajde, le të flasim atje si të na vijë, ju e dini tani që edhe kur është tema për penxheret, njerëzit flasin për derën.

Domethënë, në rastin konkret për këto pretendime është plotësisht e justifikuar që, sidomos opozita, ta ngrerë atë diskutim lidhur me veprimtarinë e Kuvendit në atë periudhë, kur është formuar Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit Shqiptar. Kjo është normale, se është brenda temës, po themi, por që nuk janë ata objekt i...

Domethënë, nëse ne bëjmë një rezolutë, nuk kanë çfarë të ndryshojnë ata, sepse ata nuk vetëndryshojnë! Këtu e pata fjalën.

**Flutura Açka** – Faleminderit, zoti Koçi!

Kush e do fjalën?

Në fakt, një nga pikat që mund t'i adresoj në këtë rezolutë Radiotelevizionit Shqiptar mund të ishte, ndoshta, që disa programe të dedikuara në lidhje me Europën, me anëtarësimin në të, çfarë do të thotë të jesh anëtar i Europës... Domethënë, duhet të fillojë një lloj fushate, mund të duket e parakohshme, por nuk është kurrë e parakohshme, sepse jo të gjithë e njohin, nuk i dimë të gjitha gjërat deri në fund.

Ndoshta ka një publik që ka nevojë edhe për këtë lloj informacioni. Mendoj se nuk është fare e parakohshme që ne të mund t'ia adresojmë këtë gjë që të bëhen programe të dedikuara për këtë gjë. Mund të jenë programe informimi, mund të jenë dokumentarë e të tjera, por ne dalëngadalë duhet ta fillojmë këtë gjë për publikun shqiptar, meqenëse është...

**Petro Koçi** – Për këtë jam dakord. Ne mund ta fusim si pikë atë. Dikush ta formulojë dhe, kur të shkojmë në seancë, t'i hedhim një sy ne, si kryesi komisioni.

Kjo është e vërtetë, sepse njerëzit thonë “integrimi europian”, por nganjëherë nuk është se e perceptojnë konkretisht se çfarë do të thotë. Kuptohet, Radiotelevizioni Shqiptar,



duke qenë televizion publik, e ka për detyrë, sepse ky është interesi i publikut dhe i institucionit. Kështu që le ta bëjmë këtë gjë.

Sigurisht, edhe ata duhet ta bëjnë në bashkëpunim, se nuk mund ta bëjnë vetë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

...ta bëjnë me Ministrinë e Jashtme, me ministri të tjera, me organizata joqeveritare, që e kanë në fokus integrimin. Kjo do të ishte gjë shumë e mirë.

Jam dakord me këtë.

**Flutura Aça** – Faleminderit, zoti Koçi!

Atëherë, formulimin e kësaj e bëjmë.

Pra, a mund të konkludojmë?

*(Njëzëri, pa mikrofon):* Po.

**Petro Koçi** – Ta votojmë me kushtin...

**Flutura Aça** – Atëherë, bëhet shtesa, përmirësimi në pikën 9, do të shtohet çështja e rekrutimit dhe ndoshta...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

...edhe për çështjen e fushatës, po, me një lloj parapërgatitjeje të publikut shqiptar për integrimin e Shqipërisë në Europë, e cila mund të jetë një gjë që është në kompetencë dhe është e bukur edhe për Radiotelevizionin Shqiptar ta bëjë këtë gjë, që i adresohet më shumë publikut.

Për çështjen e transparencës, folëm që duhet të shtojmë pikën që përditësimi të jetë një detyrim, sepse përditësimi i të dhënave në *web*-et e tyre është shumë i...

**Petro Koçi** – Mund ta redaktojmë atë dhe ta bëjmë më...

**Flutura Aça** – Atë duhet t'ia vëmë detyrë, sepse kjo na çon pastaj tek ato që thashë, në ato njollat e errëta.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, por duhet ta kthejmë në të detyrueshme.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në rregull, por kjo gjë të jetë edhe me *bold*, që të kuptohet se ne, si komision, e kemi shumë problem këtë çështje. Apo jo? Ka disa gjëra, disa pika që bëhen me *bold* enkas.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në rregull, por unë këtë çështjen e transparencës e kam pak problem. Është përmendur në dy-tri pika, por kjo të jetë e qartë për ata që u adresohet kjo projektrezolutë që ne, si komision, e kemi shumë problem çështjen e transparencës.

**Petro Koçi** – Për këtë punën e transparencës, unë të paktën isha nga ata të parët që e ngrita, sepse vërtet kam qenë i shqetësuar lidhur me mungesën e një faqeje që përditësohej,

sidomos për veprimtarinë e Këshillit. Sepse kjo është e papranueshme. Domethënë, të gjitha institucionet në Shqipëri, edhe ato më vendoret, kanë faqet e tyre, të cilat i përditësojnë, japin informacione. Ka qenë e papranueshme që Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit Shqiptar nuk kishte një *web* ku pasqyronte veprimtarinë e vet, vendimet, mënyrën si funksionon e të tjera, e të tjera. Kjo u pranua nga ata, madje thanë se ishte, si me thënë, përgjegjësi e tyre.

Kështu që unë dakord jam, edhe në qoftë se ka nevojë për ndonjë redaktim deri në seancë, e bëjmë, por që aty janë të qarta dhe janë detyrime.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Madje, mendoj se është hera e parë që ne këmbëngulim te kjo pikë.

**Flutura Açka** – Faleminderit, zoti Koçi!

Unë më shumë i referohem dëgjësës që e kam ndjekur *online* dhe pashë një lloj, po e them ashtu siç e ndieva unë, arrogancë, një lloj krekosjeje jo nga të gjithë, por nga një pjesë, një a dy veta, kishte një lloj krekosjeje të tillë: “Ne i kemi bërë punët mirë, ne, ne...”. Nuk pranoni as... Nuk e di. Kishte diçka që të paktën mua më... Prandaj edhe doja që çfarëdolloj “krekosjeje”, në thonjëza, do të doja t’i vinim detyrimin tonë që kjo gjë është e kontrolluar nga komisioni dhe kjo gjë është detyrë për t’u zbatuar.

Kur vjen puna tek Televizioni shqiptar nuk ka krekosje.

Të gjithë kemi detyrimin para publikut shqiptar të bëjmë transparencë deri në fund. Nuk ka asnjë të krekosur këtu!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Faleminderit!

Në qoftë se pastaj jemi dakord në këtë gjë, ta gjejmë një formulim, një frazë në mënyrë të atillë që kjo krekosje të zbutet pak dhe, kur të vijnë herën tjetër, të jenë më pak të krekosur këtu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në qoftë se nuk ka ndonjë...

**Petro Koçi** – Jo, ta votojmë...

**Flutura Açka** – Jo, desha të di mos ka ndonjë koleg tjetër diçka tjetër për të shtuar, që të jemi shterues deri në fund me këtë pikë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Do ta votojmë? Në rregull!

Numëroni votat, ju lutem! Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ju lutem, pa e mbyllur këtë pjesë të mbledhjes, kërkoj ndjesë nga ana ime, kam harruar të...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, projektrezoluta u miratua me....

**Petro Koçi** - Me asnjë votë kundër, asnjë votë abstenim.

**Flutura Aça** – Do të bëjmë shtesat e duhura!

Kemi miratimin e procesverbalit të datës 24 qershor, të cilin nuk jua paraqita në fillim, prandaj ju kërkoj ndjesë, se ishte pika e parë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në rregull. Miratohet procesverbali.

Faleminderit!

U votua...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Procesverbali u miratua.

Në rregull?

Faleminderit të gjithëve!

E mbyllim këtu këtë mbledhje, për të vijuar më vonë me tjetrën.

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**